



International  
Labour  
Organization



Suedi  
Sverige

## **Udhözim për Aplikim**

### **Fuqizimi i Grave Kundër Covid-19 (EWAC)**

Qëllimi i këtij udhözuesi është të orientoj kompanitë dhe parashikoj procedura transparente për zgjedhjen e kompanive që do të mbështeten për krijimin e kushteve për mbrojtjen e shëndetit në punë, veçanërisht mbrojtjen e punëtorëve nga Covid-19.

## 1. OBJEKTIVI

Ky Udhëzues synon të përdoret nga kompanitë e përpunimit dhe prodhimit të tekstit, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve, të interesuara për të marrë pjesë në komponentin e dytë të projektit "Fuqizimi i Grave Kundër Covid-19", i bashkëfinancuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP).

Komponenti i dytë i projektit "Fuqizimi i Grave Kundër Covid-19" mbështet zbatimin e ndërhyrjeve që kanë në fokus përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, veçanërisht mbrojtjen nga Covid-19.

Organizata Ndërkombëtare e Punës do të punojë drejtpërdrejt me kompanitë e zgjedhura për të vënë në zbatim planin e propozuar për sigurinë dhe shëndetin në punë. Rimëkëmbja ose krijimi i Komiteteve dypalëshe të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP) është vlerë e shtuar, si për zbatimin e masave të SSHP ashtu edhe për qëndrueshmërinë e ndërhyrjes.

### 1. FONDI I DISPONUESHEM

Buxheti i përgjithshëm për komponentin e dytë të projektit "Fuqizimi i Grave Kundër Covid-19", i cili synon mbështetjen e kompanive të zgjedhura për krijimin e kushteve të shëndetshme dhe të sigurta në vendin e punës arrin në vlerën 100 000 USD.

Kjo shumë do të shpërndahet në 10 ndërhyrjet e përzgjedhura nga Komisioni i Vlerësimit dhe kanë si qëllim përmirësimin e kushteve për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë veçanërisht mbrojtjen e punëtorëve nga Covid-19 (deri në 10 000 USD për ndërhyrje).

*Bashkëfinancimi i kompanisë aplikuese pritet të jetë të paktën 10% të kostove të pranueshme.*

## 2. KRITERET E PRANUESHMËRISE

### 2.1. Pranueshmëria e aplikantëve

Aplikimi për mbështetje financiare për përmirësimin e kushteve të punës me fokus mbrojtjen nga Covid-19 është i hapur për kompanitë e përpunimit apo prodhimit të tekstit, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve, anëtare të ProExport Albania, shoqata e vetme e ndërmarrjeve "fason", anëtare e BiznesAlbania.

Kompanitë e përpunimit apo prodhimit të tekstit, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve që kanë marrëveshje kolektive me një nga Sindikatat anëtare të Konfederatave të Sindikatave: Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) ose Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH) do të kenë prioritet.

### 2.2. Aktivitetet e pranueshme

Lista më poshtë sugjeron tipologji të aktiviteteve/ndërhyrjeve që mund të propozohen dhe adresojnë nevojat pasi ato identifikohen nga Komitetet e Sigurisë dhe Shëndetit në kompani:

- ✓ Riorganizim i hapësirave të kompanisë (vendit të punës, mensave, tualeteve) për sigurimin e distancës fizike;
- ✓ Produkte dezinfektimi për mbrojtjen e shëndetit në vendin e punës dhe sigurimin e transportit të sigurt në punë;
- ✓ Vendosja e një porte dezinfektimi në hyrje të kompanisë;
- ✓ Lehtësim i shpërndarjes së pajisjeve dhe produkteve të dezinfektimit në pika të ndryshme të kompanisë;
- ✓ Mundësimi i ujit të nxehtë në tualete;
- ✓ Instalimi i çezmave të vogla shtesë në korridoret e fabrikës ose pranë vendeve të punës për të inkurajuar larjen e shpeshtë të duarve;
- ✓ Përmirësim i kushteve në tualete (shtimi i njësisë të tualeteve aty ku është e nevojshme);
- ✓ Përmirësim i kushteve në kafene ose dhoma veshje me qëllim kufizimin e përhapjes së Covid-19;
- ✓ Vendosja e posterave ndërgjegjësues për mbrojtjen e shëndetit në punë me fokus mbrojtjen nga Covid-19;
- ✓ Përmirësim i kushteve fizike të dhomave të kujdesit mjekësor në kompani;
- ✓ Përmirësim i kondicionimit të ajrit;
- ✓ Blerja e dezinfektuesve, pajisjeve të tjera mbrojtëse, maska shumëpërdorimshe<sup>1</sup>, termometra etj.

Lista e mësipërme nuk është shteruese dhe aktivitete të tjera innovative do të mund të mbështeten.

Të gjitha ndërhyrjet duhet të zbatohen brenda kohëzgjatjes së projektit (duke filluar nga muaji Janar 2021 deri në Prill 2021).

Kosto të pranueshme do të jenë kostot që plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- janë shkaktuar gjatë zbatimit të ndërhyrjes së propozuar;
- janë të nevojshme për zbatimin e ndërhyrjes së propozuar;
- janë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit në fuqi;
- janë të arsyeshme, të justifikuar dhe përputhen me kërkesat e menaxhimit të mirë financiar.

### 3. DOREZIMI I APLIKIMEVE

**Formulari i aplikimit (Shtojca 1) duhet të dorëzohet duke përdorur** në formatin pdf (vetëm i lexueshëm) në adresën e-mail: [kopani@ilo.org](mailto:kopani@ilo.org), **deri më datë 25 Dhjetor**.

### 4. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE

Komiteti i Vlerësimit të ILO-s do të vlerësoj secilin aplikim dhe të gjithë anëtarët nënshkruajnë tabelën përmbledhëse të vlerësimit.

*Vlerësimi kryhet duke përdorur një sistem pikëzimi, ku kriteret e pikëzimit ndahen në seksione.*

---

<sup>1</sup> Projekti do të zgjedhë të blejë / porosisë maskat me shumë përdorime nga një prej kompanive të zgjedhura për projektin, nëse është e mundur, ose në një kompani tjetër prodhuese të specializuar në prodhimin e maskave të standardizuara me shumë përdorime.

Vetëm Aplikimet me 50 ose më shumë pikë do të merren në konsideratë, pasi aplikimet nën këtë prag nuk i kanë përmbushur standardet e përcaktuara, duke vënë në dyshim efikasitetin e aftësisë së tyre për zbatim.

## 5.1 Sistemi i vlerësimit

### Pjesa I: Kontrolli administrativ

KERKESAT E DETYRUESHME	KALON PER VLERESIM NE SEKSIONIN II	NUK KALON PER VLERESIM NE SEKSIONIN II
1. Kompania është e regjistruar dhe aktive		
2. Anëtarësimi në ProExport Albania (BA)		
3. Krijimi i Komitetit të SSHP		
4. Stabiliteti financiar i siguar		
5. Dorëzuar brenda afatit		

### Pjesa II: Vlerësimi Teknik

Seksioni	Maksimumi i pikëve	Vlerësimi
<b>Marrëveshje kolektive me KSSH ose BPSH</b>	<b>10</b>	
<b>1. Relevanca e ndërhyrjes</b>	<b>30</b>	
1.1. Sa e rëndësishme është ndërhyrja e propozuar për objektivat dhe përparësitë e Thirrjes për Aplikime?	10	
1.2. Sa e rëndësishme është ndërhyrja për garantimin e sigurisë dhe kushteve më të mira të punës për gratë punëtore? A janë përcaktuar qartë nevojat e tyre dhe a i adreson ndërhyrja e propozuar në mënyrë të përshtatshme?	10	
1.3. Sa qartë është përcaktuar dhe a është zgjedhur strategjikisht ndërhyrja e propozuar?	5	
1.4. A përmban aplikimi elementë të veçantë që konsiderohen vlerë e shtuar (p.sh. inovacion, praktikat më të mira)?	5	
<b>2. Efektiviteti</b>	<b>30</b>	
2.1. Sa koherent është modeli i përgjithshëm i ndërhyrjes? A pasqyron analizën e problemeve të SSHP dhe Covid-19?	10	
2.2. A do të ketë ndikim të drejtpërdrejt në mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit në punë të grave punëtore?	10	
2.3. A është veprimi i realizueshëm dhe i qëndrueshëm në lidhje me objektivat dhe rezultatet e pritura?	10	
<b>3. Buxheti</b>	<b>30</b>	
3.1. A është pasqyruar ndërhyrja në mënyrë të përshtatshme në buxhet?	10	
3.2. A janë të nevojshme kostot e sugjeruara për zbatimin e projektit?	5	
3.3. A është i kënaqshëm raporti midis kostove të vlerësuara dhe rezultateve të pritura?	5	
3.4. A do të kontribuoj kompania me të paktën 10% në zbatimin e planit të ndërhyrjes? A është elaboruar mirë?	10	
<b>Maksimumi i pikeve totale</b>	<b>100</b>	
<b>Besueshmëria (Konfirmimi i nevojës nga Komiteti i Vlerësimit të ILO-s gjatë Vizitës në Terren)</b>	<b>Përzgjidhet</b>	<b>Nuk përzgjidhet</b>

## **5. NJOFTIMI MBI VENDIMIN**

Aplikantët do të njoftohen për rezultatet e vlerësimit në adresat e emailit me të cilat është aplikuar ose parashikuar në formularin e aplikimit.

## **6. KUSHTET E LIDHURA ME ZBATIMIN E PROJEKTIT PAS MIRATIMIT**

Pasi të jetë marrë vendimi për miratimin e Aplikimit të propozuar, aplikantit do t'i ofrohet ndihmë teknike, financiare dhe administrative për zbatimin e ndërhyrjes. Kjo do të thotë që ILO NUK do të transferojë fondet tek Aplikanti, por do të sigurojë të gjitha fondet dhe mbështetjen për zbatimin e Ndërhyrjes.

ILO ka të drejtë të kërkojë disa modifikime të propozimit, në mënyrë që ta harmonizojë atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit.

## Shtojca 1: Formulari i aplikimit



### Formular Aplikimi Fuqizimi i Grave Kundër Covid-19 (EWAC)

#### INFORMACION RRETH APLIKANTIT

Numri i identifikimit të ndërmarrjes (NIPT)		
Emri i kompanisë		
Numri i punëtorëve		
Sipërfaqja e kompanisë		
Anëtarësimi në ProExport Albania (anëtar i BiznesAlbania)	Po	Jo
Marrëveshje kolektive me Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) ose Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH)	Po	Jo
Përbërja e Komitetit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (Emri / Mbiemri)	Pozicioni	
Adresa	Shteti	
Personi i kontaktit	Email	Nr. telefoni

## 2. INFORMACION RRETH NDËRHYRJES SË PROPOZUAR

### 2.1 Përshkrimi i nevojave specifike

Ju lutemi shpjegoni nevojën për mbështetje në përmirësimin e kushteve të punës dhe zbatimin e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, veçanërisht mbrojtjen nga Covid-19. (maksimumi 200 fjalë)

### 2.2 Përshkrimi i ndërhyrjes së propozuar

Ju lutemi jepni një shpjegim të hollësishëm të ndërhyrjes së propozuar (maksimumi 300 fjalë)

### 2.3 Rezultatet e pritshme

Përshkruani rezultatin e pritur dhe se si do të kontribuojë në përmirësimin e sigurisë dhe kushteve të punës së punëtorëve (maksimumi 200 fjalë)

### 2.4 Kohëzgjatja (datat) e ndërhyrjes

Ndërhyrja është planifikuar të zbatohet nga <DD / MM / VVVV> në <DD / MM / VVVV>.

### 3. BUXHETI

*Ju lutemi hartoni një buxhet përmbledhës të kostove të parashikuara për ndërkyrjen e propozuar*

<i>Objekti ose shërbimi i kërkuar</i>	<i>Kosto e përafërt</i>	<i>Koment</i>

*\*Ju lutem, konfirmoni kontributin tuaj (10% të kontributit të kërkuar) në ndërhyrje.*

### 4. PYETËSOR NE LIDHJE ME KUSHTET DHE SIGURINE NE PUNE

*Ju lutemi plotësoni me “X” kutinë që është relevante për kompaninë tuaj*

1. A janë trajnuar punëtorët për masat e miratuara për parandalimin e rrezikut të ekspozimit ndaj virusit dhe për mënyrën e veprimit në rast të infeksionit Covid-19?			PO	JO	
2. A ka hapësirë në fabrikën tuaj për të siguruar distancën 2 metra mes vendeve të punës?					
3. A keni postera ndërgjegjësimi me udhëzime emergjente në të gjithë fabrikën (përpos Protokollit të Kuq)?					
4. A keni vendosur xhama mbrojtës ndërmjet vendeve të punës së punëtorëve?					
5. Sa shpesh dezinfektoni me spërkatje të gjithë fabrikën, përfshirë mjetet dhe pajisjet e zakonshme të prodhimit?	Një herë në ditë		Një herë në javë	Një herë në muaj	
	Disa herë në ditë				
6. A dezinfektohen punëtorët para se të hyjnë në fabrikë? <i>Nëse po, mënyra e dezinfektimit.</i>	PO	JO	Dezinfektant duarsh	Dezinfektim me spërkatje në hyrje	Tapet dezinfektues
7. A keni stok maskash që i ofroni në hyrjen kryesore të fabrikës?			PO	JO	
8. A ka termometra të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për të kontrolluar temperaturën e trupit të të gjithë punëtorëve në hyrje?					
9. Sa pika të dezinfektimit të duarve keni në fabrikën tuaj?			Numri		

10. Sa pika të larjes së duarve keni në kompaninë tuaj? ( <i>Lavaman, çezmë</i> )			
11. A ka ujë të rrjedhshëm në tualetin/et e fabrikës suaj?		PO	JO
12. A ka detergjent në tualet/e?			
13. Sa herë dezinfektohet tualeti/et?		Numri	
	Peshqir	Tharëse	Kartopçeta
14. Çfarë përdoret për të tharë duart në tualet/e?			
15. A mundësoni transport për punëtorët tuaj?		PO	JO
16. Nëse po, a e dezinfektoni mjetin e transportit?			
17. A keni hasur vështirësi në kontrollimin e dezinfektimit?			

## **5. DATA DHE KONFIRMIMI**

Konfirmoj që informacioni i dhënë në këtë formë është i plotë dhe i saktë për sa kam njohuri.

Vendi dhe data	Emri / Pozicioni / Firma